Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e çmimeve të artikujve

N.	Pershkrimi	Njesia	Sasia
1	Punime Civile	Set	1
2	F.V Dere zjarrdruuese	Cope	1
3	F.V DysHEME Teknologjike	m2	13
4	F.V Panel Elektrik - Krahu A	Set	1
5	Instalime Elektrike	Set	1
6	ndricimi normal edhe I emergjences		
7	kanalinat		
8	kabllo		
9	tokezim, etj		
10	F.V UPS 10KVA	Cope	1

11	F.V PDU 32 A	Cope	4
12	F.V Sistem Kondicionimi 12kË	Set	1
13	F.V Rack 42U 600x1000	Cope	1
14	F.V Netëork	Set	1
15	instalime bakri		
16	patchpanele		
17	menaxhues kablli		
18	kanaline e verdhe dhe aksesore		
19	F.V Sistemi I Kontrollit, monitorimit dhe menaxhimit te ambjentit dhe paisjeve	Set	1
20	F.V Sistem I detektimit dhe shuarjes se zjarrit	Set	1
21	F.V Sistem CCTV	Set	1
22	3 Kamera		
23	NVR per monitorimin e dhomes se serverave		
24	F.V Sistem Akses Control	Set	1
25	Fireëall	Cope	1
26	Server (nyja e perpunimit te informacionit)	Cope	3
27	Data Storage	Cope	1
28	Sëitch "Top of the Rack"	Cope	1
29	Zgjidhje backup Disk to Disk dhe softëare per backup dhe replikim	Set	1
30	SAN Sëitch	Cope	1
31	Sherbime instalimi dhe konfigurimi	Cope	1

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkreisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. HYRJE

Krijimi i Disaster Recovery Site është konceptuar duke marrë në konsideratë faktin se është pika më sensible e sistemit informatik dhe përqendrimi paisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës. Demet eventuale të shkaktuara në këto ambiente do të sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjitha sistemeve informatike dhe të të dhënave të digjitalizuara. Për këtë arsye, të gjitha instalimet duhet të kryhen sipas standardeve të përcaktuara për të garantuar operimin në kushte optimale të gjitha paisjeve që instalohen në dhomen e serverave, si edhe për të siguruar mbrojtjen e informacionit nga aksesit i paautorizuar apo nga demtime të tjera të mundshme.

Për këtë qëllim, ka hartuar një projekt duke pasur parasysh ambientin ku do të ndërtohet dhoma e serverave, si edhe sasinë e paisjeve që do të instalohet në këtë dhomë, duke mbajtur parasysh mundësinë për shtim kapacitetesh në të ardhmen.

2. QELLIMI

Qëllimi i këtij projekti është ndertimi i një Dhome Serverash, që plotëson kërkesat tekniko-funksionale për të garantuar operimin në kushte normale të paisjeve, si edhe për të mbrojtur paisjet nga aksesit i paautorizuar dhe nga demtimet e mundshme.

Me konkretisht, dhoma e serverave duhet të garantojë:

- Hapësirë e nevojshme për të instaluar paisjet teknologjike
- Temperaturë konstante
- Lagështinë normale
- Furnizim me energji të vazhdueshme
- Mbrojtje të paisjeve nga zjarri
- Kontroll të aksesit në dhomen e serverave
- Monitorim të dhomes së serverave

Për të arritur në këtë qëllim, kërkohet instalimi dhe vendosja në punë e disa sistemeve, si edhe kryerja e punimeve civile.

Me konkretisht, kërkohet:

1. Punime civile, të cilat përfshijnë:
 - Mbylljen e një dritareje ekzistuese
 - Zgjerimin e derës ekzistuese
 - Vendosjen e një dërrë të pershtatshme për dhomë serverash
 - Lyerje të ambientit
 - Trajtimin e dyshemese me bojë antilageshti dhe antipluhur
2. Instalimi i dyshemese teknike
3. Instalimi i derës zjarrduruese, të pershtatshme për Dhomë Serverash

-
4. Instalimet elektrike brenda dhomes se serverave qe perfshijne instalimin e panelit elektrik, dhe shtrimin e linjave per furnizimin me energji te paisjeve brenda ne dhome
 5. Instalimin e sistemit UPS. (Projekti paraqet nje sistem redundant per UPS, por ne kete faze do te instalohet vetem nje UPS. UPS-ja tjeter do te instalohet me vone)
 6. Instalimin e sistemit te kondicionimit CRAC. (Projekti paraqet nje sistem redundant per sistemin e kondicionimit, por ne kete faze do te instalohet vetem nje kondicioner. Kondicioneri tjeter do te parashikohet per tu instaluar ne te ardhme)
 7. Instalimin e Rackeve, aksesoreve peraktes dhe PDU-ve
 8. Instalimin e rrjetit te komunikimit baker dhe fiber midis rakeve.
 9. Sistemin e dedektimit dhe shuarjes se zjarrit
 10. Sistemin e monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit
 11. Sistemin CCTV dhe te kontrollit te aksesit

3. AMBJENTI AKTUAL

Ambjenti ku do te ndertohet dhoma e serverave eshte me dimensione 3.55 x 3.75m dhe lartesia ne dhome nga dyshemeja e godines deri ne tavan eshte 3.2m.

Ky ambjent do te trajtohet duke bere nderhyrjet e nevojeshme per tu pershtatur ne dhome serverash.

4. PLANVENDOSJA E PAISJEVE NE DHOMEN E SERVERAVE

Pas nderhyrjeve ne ambjentin aktual, paisjet ne dhomen e serverave duhet te instalohen sipas plan vendosjes se meposhteme (sasite e pajisjeve paraqesin si do te duket dhoma e kompletuar me redundance 2N, por ne kete faze te projektit nuk do te prokureohen te gjitha pajisjet. Ne menyre te detajuar jepen pajisjet ne planifikimin e buxhetit):




Figure 1 - Planvendosja e Paisjeve ne Dhome

5. PUNIMET CIVILE

Ambjenti aktual ku do te ndertohet dhoma e serverave ka nevoje per punime civile jo te specializuara, ne menyre qe te pershtatet per Dhome Serverash. Me konkretisht, ne ambjent duhet te kryhen keto punime civile:

- Mbyllja e nje dritareje ekzistuese me dimensione 1.8 x 1.8m
- Zgjerimi i kafazit te deres ekzistuese nga 90cm qe eshte aktualisht ne 120cm.
- I gjithë ambjenti duhet te lyhet me boje te bardhe.
- Dyshemeja duhet te trajtohet me boje kundra lageshtise dhe kundra pluhurit.

OE do te jete pergjegjes per zhvendosjen e sigurte te mbetjeve te materialeve te ndertimit si edhe per pastrimin e ambientit. Hedhja e materialeve te mbetura duhet te kryhet ne perputhje me ligjet dhe rregulloret, per menaxhimin e mbetjeve te ndertimit si dhe riciklimit ne Republiken e Shqiperise.

6. DERA ZJARRDURUESE

Ne dhomen e serverave duhet te instalohet nje dere zjarrduruese me permasa minimalisht 120 cm x 220cm per te lejuar futjen dhe nxjerrjen lehtesisht te pajisjeve te permasave te medha (Rack, Kondicioner etj).

- Dera duhet te jete zjarrduruese me kohe minimale 60 minuta.
- Te jete me hapje nga jashte me doreze antipanik dhe me mekanizem vetembylles.
- Te jete me sistem hapjeje te kontrolluar me elektromagnet te lidhur me Sistemin e Akses Kontrollit.

7. DYSHEMEJA TEKNOLOGJIKE

Ne dhomen e serverave duhet te montohet dysHEME teknologjike, me pllaka te levizshme e grila ajrimi, per te bere te mundur plotesimin e Standardeve te rendesishme te nje Dhome Serverash.

Lartesia e dyshemese teknologjike nga bazamenti duhet te jete midis 40-45cm per te bere te mundur qe poshte saj te realizohet pjesa me e madhe e instalimeve elektrike, kondicionimit, sensore te ndryshem si dhe te mundesoje qarkullimin e ajrit te ftohte, nga njesia e kondicinimit drejt rack-eve, nepermjet aksesoreve te ventilimit.

Korridoret e qarkullimit te rrymave te ftohta/ngrohta te ajrit duhet te orientohen e planifikohen ne menyre te tille qe te pershtaten dhe te ecin ne te njejten linje me pllakat e dyshemese teknologjike.

DysHEMEJA duhet te kete peshembajtje te mjaftueshme per te siguruar mbajtjen e pajisjeve qe do te instalohen mbi te.

DysHEMEJA duhet te suportohet nga nje bazament me perberje celiku te galvanizuar i fiksuar ne nenstrukture me adezive dhe me dy fiksues mekanike per te siguruar lartesine e nevojshme. Bazamenti duhet te kompletohet me nje veshje anti-vibruese. Per arsye sigurie dhe qendrueshmerie (ne rast te nderrimit te pllakave) pllakat duhet te kornizohen me shina.

DysHEMEJA teknologjike duhet te perbehet nga:

- Pllaka me dimezime 600x600mm/600x1000 mm.
- Struktura mbeshtese e perbere teresisht nga çeliku i galvanizuar
- Kembe me lartesi te rregullueshme
- Tranversa te perbera prej profili "C". (Tranversat/bashkueset jane te vendosura ne pjesen e poshtme per te rritur qendrueshmerine ndaj perkuljeve).
- Material plastik i zi kundra zjarrit i montuar ne pjesen e sipërme te tranverses (gomine kundra zjarrit).

7.1 Pllakat

Materiali i pllakave te perdorura per dyshemene teknologjike duhet te jete material mineral i perforcuar me fibra per te permbushur nevojat per peshembajtje. Kompozimi i pllakave duhet te permbushë parametrat e meposhtme:

-
- Dimensionet e pllakave 600x600mm/600x1000 mm
 - Trashësia: 30 - 40 mm
 - Pjesa anësore të jetë e veshur me plastik të dallueshme ngjyre të zeze
 - Pjesa e poshtme e pllakes duhet të jetë me veshje alumini

7.2 Grilat e ajrimit

Per të siguruar një efikasitet sa më të mirë të fryrjes së ajrit të ftohtë dyshemeja teknologjike duhet të jetë e pajisur me grila ajrimi për të bërë të mundur qarkullimin e ajrit të ftohtë nga poshtë dyshemese në pjesën ballore të rack-eve. Ky ventilim duhet të realizohet nepermjet grilave të ajrimit (penele metalike) të cilat duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:

- Të jenë në dimensionet 600x600mm/600x1000mm, në varesi të pllakes
- Të jenë të pershtatshme për dyshemene teknologjike dhe me të njëjten trashësi sa pllaka.
- Të mbështeten mbi strukturën e dyshemese dhe të jenë në nivel me pllakat e dyshemese.
- Të jenë të të njëjtit prodhues me pllakat

7.3 Rampa

Per lehtësimin e futjes së paisjeve të rënda si edhe për të mundësuar hyrjen e personelit në dhomë, duhet të ndërtohet një rampë (pedane). Rampa duhet të ndërtohet duke mbajtur në konsideratë sigurinë e përdoruesve. Per këtë arsye rampa duhet të ndërtohet me sipërfaqe jo të rreshqitëshme.

8. KABINETET

Në dhomën e serverave do të instalohen 1 kabinet e ri. Gjithashtu në ambientin ekzistues ndodhet një kabinet në të cilin mbledhen kabllimet e rrjetit kompjuterik të gjykates, i cili do të qëndrojë në dhomë.

Kabineti i ri që do të instalohet duhet të jetë me permasa minimalisht, lartësia 42U, gjerësia 600mm dhe thellësia 1000mm.

Pozicionimi i 2 rack-eve në dhomë (racku ekzistues dhe racku i ri që do të furnizohet) duhet të jetë i tillë që të lejojë shërbimin ndaj rackeve dhe pajisjeve të instaluar në to si në pjesën e përparme, ashtu edhe në atë të mbrapme.

Racku i ri duhet të sigurojë 42U hapësirë vertikale. Shinat vertikale duhet të jenë lehtësisht të rregullueshme për të lejuar thellësi të ndryshme. Çdo shinë vertikale duhet të jetë e shënuar në të dyja anët me linjat që tregojnë fillimin dhe në fund të çdo U dhe numrin e hapësirës U. Të dy dyert (para dhe pas rack-ut) duhet të jenë të dizajnuara me mentesha për heqje të shpejtë të dyerve pa përdorur vegla. Dyert para dhe mbrapa duhet të hapen një

minimum prej 180 grade per te lejuar akses te lehte ne pjesen e brendshme. Rack-u duhet te perfshije panele anesore gjysme-lartesi qe mund te hiqen pa perdorur vegla. Panelet anesore duhet te jene te rrafsheta me Rack-un keshtu qe gjeresia e pergjithshme e njesise nuk do te ndryshoje me panele anesore te instaluara. Te gjitha komponentet e Rack-eve te tilla si dyer, panele anesore, çati, etj. duhet te lidhen direkt ne strukturen e rackut. Gjithashtu duhet te sigurohen pika te cilat mundesojne tokezimin e Rack-eve. Racket duhet te kene mbrojtje IP20 edhe te ofrojne nje peshembajtje statike te pakten 800kg.

Rack-et duhet te kete dyer te cilat krijojne mundesi per ventilim ne pjesen para / pas / lart etj. si dhe duhet te mundesoje hapje nga siper dhe poshte per te menaxhuar kabllot ne Rack.

Rack-et duhet te perfshije kontroll aksesi ne dyert e perparme dhe te pasme.

Specifikimet e rackeve duhet te jene minimalisht si meposhte:

Parametrat e Rackut	
Lartesia	42U
Gjeresia	600 mm
Thellesia	1000 mm
Dera perpara	E ventiluar, minimalisht 86%
Celesi perpara	Dorezë me rrotullim dhe celes
Dera pas	Me dy ndarje vertikale, te ventiluara, minimalisht 86%
Celesi pas	Dorezë me rrotullim dhe celes
Panelet anesore	Dy panele anësore, te paisur me celes dhe lehtesisht te heqeshme.
Pllaka e sipërme (tavani)	E heqeshme, nje pllake e vetme, hyrje kabllosh drejtekendeshe me dimensione minimalisht 300x100mm te mbuluara me flete metalike (qe mund te hiqet)
Pllaka e poshteme (dysHEMEJA)	E heqeshme, nje pllake e vetme, hyrje kabllosh drejtekendeshe me dimensione minimalisht 300x100mm te mbuluara me flete metalike (qe mund te hiqet)
Aksesore per futjen e kablllove	Ne pllaken e sipërme (tavanin) dhe pllaken e poshteme (dyshemene) e kabinetit, duhet te kete nga nje aksesore me furca per futjen e kablllove me dimensione minimalisht 300x100mm.

Shinat vertikale	<p>Ne pjesen e perparma duhet te kete 2 shina vertikale te plota, te cilat mund te zhvendosen ne rrafshin horizontal (para dhe pas).</p> <p>Ne pjesen e pasme duhet te kete 2 shina vertikale te plota, te cilat mund te zhvendosen ne rrafshin horizontal (para dhe pas).</p> <p>Te gjitha shinat vertikale duhet te kene te shenuara cdo RU (RU 1, RU2,...RU42).</p>
Klasa IP:	Min.IP20
Peshembajtja e balancuar:	minimalisht 800 kg

Kabinetet duhet te instalohen ne nje rresht, sipas planvendosjes se dhomes qe jepet me lart.

Kabineti i ri, duhet te kete te instaluar:

1 cope Sistemues kablli vertikal me gjeresi minimalisht 150mm, e paisur me suportet/aksesoret per montim vertikal ne kabinetin e kabllimeve.

2 cope Kite per futjen e kablllove ne pjesen e sipërme te rackut, me furce ng ate dy krahet. Dimensionet e kitit duhet te jene aq sa eshte hapja per kalimin e kablllove ne kabinet.

2 cope Sistemues horizontal, prej materiali plastik me kapak

Gjithashtu per kabinetin ekzistues, ne menyre qe te sistemohen kabllot ne kabinetin ekzistues duhet te furnizohen dhe instalohen edhe

Duhet te kete te instaluar:

2 cope Sistemues kablli vertikal me gjeresi minimalisht 150mm, e paisur me suportet/aksesoret per montim vertikal ne kabinetin e kabllimeve.

6 cope Sistemues horizontal, prej materiali plastik me kapak

Meposhte, jepen foto ilustruese te aksesoreve qe duhet te jene te instaluar ne kabinetete.



Figure 3 - Kanaline Grile



Figure 4 - Sistemues Vertikal



Figure 3 - Sistemues Horizontal



Figure 2 - Aksesore per futjen e kablllove

9. INSTALIMET ELEKTRIKE

Ne dhomen e serverave do te instalohet infrastruktura e nevojeshme elektrike per furnizimin me energji te vazhdueshme te te gjitha sistemeve dhe paisjeve qe do te instalohen ne dhome. Instalimet elektrike do te perfshijne:

- Instalimin e nje paneli elektrik qe te siguroje furnizimin e nevojshem me energji te vazhdueshme.
- Rrjetin e shperndarjes brenda ne dhome qe perfshin kanalinat dhe kabllot elektrike. Per secilin rack do te instalohen nga dy linja elektrike te mbrojtura dhe furnizuara me energji te vazhdueshme nga UPS qe do te instalohen ne dhomen e serverave.
- Rrjetin e shperndarjes per furnizimin e kondicionerit CRAC te dhomes me linja 3-fazore.
- Instalimin e ndricimit normal dhe te emergjences
- Rrjetin e shperndarjes per sistemet e tjera sic jane sistemi i dedektimit dhe shuarjes nga zjarri, sistemi i monitorimit, sistemi CCTV dhe kontrollit te aksesit.
- Instalimin e dy UPS-eve

- Instalimin e PDU-ve neper kabinete

9.1 Paneli Elektrik

Paneli elektrik qe do te instalohet brenda ne dhomen e serverave do te sherbeje per furnizimin me energji te te gjitha sistemeve dhe paisjeve qe do te instalohen ne dhome.

Për efekt sigurie, sidomos kur dyert e panelit janë të hapura, të gjitha zbarat duhet të mbulohen në të gjithë sipërfaqen e tyre. Për të lehtësuar aksesin ne panelin elektrik në rastet kur do të bëhen veprime për mirëmbajtjen paneli duhet të përbëhet nga pjesë të çmontueshme. Për të siguruar mbrojtje maksimale ndaj njerëzve, pjastrat ballore të të gjitha paisjeve duhet të instalohen në pjesën e përparme, për të shmangur aksesin e drejpërdrejtë në pjesën që nuk janë të izoluar.

Skema e panelit elektrik, minimalisht duhet te perfshije komponentet e meposhteme. OE mund te propozojne skema me optimale, ne baze te projektit te tyre.




Figure 4 - Skema e Panelit per furnizimin nga UPS_1 (ilustrim)




Figure 5 - Skema e Panelit per furnizim nga UPS_1 (ilustrim)

Sic duket dhe nga skema e panelit elektrik, furnizimi nga secila UPS do te behet duke perdorur nje celes transferimi manual te ngarkeses nga UPS ne linje direkte. Pra paisjet do te furnizohen direkt nga UPS, por ne rastet kur UPS mund te kete nevojte per sherbime miremebajtje ose ne rast difektimi, me ane te celesit te transferimit manual, ngarkesa duhet te kaloje ne linje direkte. Celesi i transferimit manual te ngarkeses duhet te perdoret per te dyja UPS-te.

Per furnizimin me energji te kondicionimit, duhet te instalohet dhe mbrojtjes faze.




Figure 6 - Skema e panelit per furnizimin e AC dhe sistemeve te tjera (ilustrim)

9.2 Rrjeti i Shperndarjes

Rrjeti i shperndarjes perfshin kanalinat metalike, tubat, kabllot elektrik si edhe prizat industriale per furnizimin e kabineteve.

9.2.1 Kanalinat Metalike

Te gjitha kabllot elektrike do te shtrihen ne kanalina metalike rrjete qe do te montohen nen dyshemene teknike. Kanalinat duhet te montohen me aksesoret perkates mbi nivelin e dyshemese se dhomes. Çdo dalje nga kanalina rrjete duhet te behet me tuba fleksibel, ose rigid sipas nevojës e shoqeruar me aksesoret perkates.

Vec kanalines qe do te perdoret per instalimet elektrike, nen dyshemene teknologjike do te insalohet edhe nje kanaline tjeter qe mund te perdoret per kalimin e kablllove Ethernet per lidhjen e portave SNMP, apo kablllove te sinjalizimeve per te lidhur sensore/dedektore te ndryshem. Keto dy kanalina duhet te ndjekin rruge te ndryshme, sipas plan vendosjes se paisjeve ne dhome.

9.2.3 Kabllot Elektrike

Te gjithe tipet e kabujve qe do te instalohen duhet te jene te tipit FG16OM16, me emetim te ulet te tymit toksik dhe gazrave gerryes ne temperature deri ne 90°C. Kabllot duhet te jene konform kerkesave te rezistences ndaj zjarrit sipas EN 50575: 2014 + A1.

Seksionet dhe gjatesite e kablllove per secilin sistem, si edhe te gjithe aksesoret instalimor, do te perlogariten nga operatorët ekonomik.

Poshte secilit kabinet do te instalohen 2 priza industriale 32A 1-fazore, njera prize do te insalohet ne krahun e djathte te rackut, dhe tjetra ne krahun e majte. Ne keto priza do te furnizohen PDU-te e montuara ne rack. Prizat industriale, PDU-te, UPS dhe linjat e furnizimit duhet te etiketohen me ne te njejtin emertim (Psh: UPS_A, PDU_A, Priza_A, Linja_A, apo UPS_B, PDU_B, Priza_B, Linja_B).



Figure 7 - Priza Industriale 32A

9.3 Ndrëçimi i dhomes

Per ndrëçimin e ambientit duhet te respektohet kushti prej 500 Lux ne planin horizontal dhe 200 Lux ne planin vertikal, e matur kjo 1m mbi dyshemene e ngritur ne aksin e korridoreve ndermjet rack-eve.

Per ndrëçimin normal te ambienteve duhet te insalohen ndrëçues LED tavanor linear. Ne dhome do te insalohen 4 ndrëçues te tille, dy ne pjesen para kabineteve dhe dy ne pjesen pas kabineteve. Pozicionimi duhet te jete paralel me rreshtin e kabineteve dhe jo ne pjesen mbi pajisje me qellim qe te ndrëçohet zona para e mbrapa tyre. Komandimi (ndezja/fikja) duhet te jete ne nje celes ne hyrje ted homes se serverave, nga brenda. Furnizimi i ndrëçimit duhet te behet me kabell 1.5mm² te futur ne tub ridgid. Instalimi i ndrëçimit duhet te plotesoje te gjitha kushtet e siperpermendura per mbrojtjen e kablllove dhe percjellesave.

Vec ndrëçuesve normal, ne dhome duhet te kete edhe ndrëçim emergjence. Ndrëçuesit e emergjences duhet te jene te paisur me inverter dhe bateri, ne menyre qe te garantojne ndrëçim per te pakten 1 ore nga nderprerja e energjise. Ndrëçuesat e emergjences duhet te tregojne gjendjen e ndrëçuesit dhe te baterive si edhe te pajisen me sinjalistiken perkatese. Ne dhome do te instalohen dy ndrëçues emergjence ne tavan, njeri ne pjesen e perparme te rreshtit te kabineteve dhe tjetri ne pjesen e pasme.

Furnizimi me energji i ndricuesve nga paneli elektrik do te behet duke perdorur tuba rixhid sebashku me aksesoret perkates te insalimit.

10. SISTEMI I FURNIZIMIT TE VAZHDUESHME TE ENERGIJE (UPS)

Ne dhomen e serverave duhet te instalohet nje UPS per te siguruar mbrojtjen dhe autonome e paisjeve te instaluara ne dhomen e serverave.

Kapaciteti i UPS duhet te jete 10kVA, 3 fazor ne hyrje dhe 3 fazor ne dalje. UPS duhet te kete bateri te brendeshme qe garantojne autonomi per minimalisht 10minuta, ne ngarkese 70%. UPS duhet te jete teknologji "On-Line", me konvertim te dyfishte AC-DC dhe DC-AC. UPS duhet te kete komponentet baze si rectifier (radrizzatorin), inverter, karikuesin e baterive, panelin e kontrollit dhe monitorimit, server komunikimi te integruar dhe procesorin e sinjaleve digjitale (DSP).

Nese energjia nga rrjeti nderpritet ose parametrat jane jashte diapazonit te lejuar te hyrjes se UPS, atehere UPS duhet te furnizojte me energji paisjet nepermjet baterive. UPS duhet te kete te integruar nje "bypass" emergjence. UPS gjithashtu duhet te filtroje dhe normalizojte parregullsite e parametrave te hyrjes, dhe te furnizojte ne dalje tension me harmonike te paster dhe parametra stabel.

Specifikimet teknike te UPS duhet te jene minimalisht si meposhte:

Teknologjia: On-line, double conversion AC-DC and DC-AC

Eficensa AC-AC: minimalisht 95%

Dalja

Fuqia : 10kVA / 10 kVA

Tensioni Nominal ne dalje : 400V 3PH

Tensione te tjera : 380, 415V

Rregullimi tensioni ne dalje : +/- 3%

Frekuenca ne dalje : 50/60 Hz

Rregullimi i frekuences ne dalje : $\pm 3\%$

Forma e vales : Sinusoidale

Deformimi i harmonikes ne dalje: < 3% ngarkese lineare

Hyrja

Tensioni Nominal ne hyrje : 400V 3PH

Frekuenca ne hyrje: 45 - 65 Hz

Lidhja ne hyrje : Kabell (3PH + N + G)

Diapazoni i tensionit ne hyrje per operim normal: 310 - 475 ne ngarkese te plote

Tensione te tjera : 380, 415

Deformimi total i harmonikes : < 3% per ngarkese te plote

Baterite

Tipi i Baterise : VRLA ose ekuivalent

Autonomia : jo me pak se 10 min ne 70% ngarkese

Nderfaqja e rrjetit : Po

Panel kontrolli : LCD Multi-funksional dhe tastjere kontrolli

Buton emergjence (EPO) : Po

Funksione te tjera

Lidhje ne parallel : PO

EPO lokalisht dhe ne distance: PO

Bypass sëitch per mirembajtje: PO

Panel operimi : Ekran me prekje, me ngjyra

Nderfaqet

Porte per lidhje ne parallel : PO

Porte USB : PO

Porte RS232 : PO

Porte RJ45 : PO, SNMP

Hyrje “dry contact” : minimalisht 2

Dalje “dry contact” : minimalisht 2

Certifikim : CE

Ambjenti

Ambjenti i punes : 0 - 40 °C

Niveli i lageshtires : 5 - 95%

Zhurma nga 1m largesi : < 62dBA

Garancia : 1 vit

11. SHPERNDARESIT E ENERGJISE NE RACKE (PDU)

Per shperndarjen e energjise brenda rackeve do te instalohen PDU (Poëer Distribution Unit) vertikale ne pjesen e pasme te secilit rack. Ne secilin kabinet do te instalohen dy PDU, PDU_A ne krahun e djathte dhe PDU_B ne krahun e majte. PDU_A do te furnizohet nga UPS, dhe PDU_B do te furnizohet nga rrjeti.

PDU-te duhet te jene me kapacitet 32A, duhet te jene te monitorueshme me SNMP. PDU-te e monitorueshme duhet te sigurojne optimizimin e energjise dhe mbrojtje te qarkut, ne menyre qe te ulin rrezikun ne kohe reale dhe te krijojne mundesine per te paralajmeruar rastet e mbingarkesave te mundshme ne qarkun e furnizimit me energji elektrike.

PDU-te duhet te aksesohen dhe konfigurohen nepermjet nderfaqes Eëb te sigurte, me ane te protokollit SNMP. Secila PDU duhet te kete minimalisht 24 porta IEC 320 C13 dhe minimalisht 4 porta IEC 320 C19 ne dalje.

Specifikimet teknike te PDU-ve duhet te jene minimalisht:

Tensioni dhe rryma ne dalje	: 230VAC
Tensioni dhe frekuenca ne Hyrje	: 220V/230V/240V, 32A
Tensioni i pranueshem ne hyrje	: 200-240 VAC, Hyrja: IEC 309 32A 2P+E
Nderfaqet firmëare	: porta per te lidhur PC per operim dhe perditësim
	: SNMP per monitorim ne distance
Temperatura e punes	: 0~40°C
Lageshtia relative	: 5~95%
Certifikim	: CE
Garancia	: 1 vit

Për panelin elektrik ofertuesi duhet të paraqesë projektet dhe skemat elektrike te detajuara, si dhe projektet e instalimeve në përmasa reale për të shmangur çdo lloj problemi që mund të dalë për shkak të hapësirës ose mosfunksionimit të sistemit.

12. RRJETI BAKER DHE FIBER

Kabinetet do te jene te nderlidhura me rrjet Ethernet baker dhe fiber, ne menyre te tille qe paisjet e instaluar ne secilin prej kabineteve te kene mundesi te lidhen me njera tjetren lehtesisht, duke perdorur vetem patch corda.

Per kete qellim, kabineti i kabllimit do te perdoret si kabinet interkoneksioni; qe do te thote ne secilin prej kabinteve te serverave (SR1 dhe SR2), do te insalohet nga nje patch panel Ethernet me 24 porta RJ45, dhe nga nje ODF me 12 porta LC Duplex SM; ne kabinetin e kabllimit, per secilin kabinet te serverave, do te instalohen patch panelet dhe ODF repsektive.

Kalimi i fibres optike dhe kablllove Ethernet, per nderlidhjen midis kabineteve do te behet nepermjet kanalines se verdhe, te instaluar mbi kabinetet.

Meposhte jepet nje diagrame e pozicionimit te paisjeve ne kabinetet:




Figure 8 - Pozicionimi i paisjeve te rrjetit pasiv

12.1 Rrjeti i Fibres Optike

Diagramat e lidhjes se fibres optike do te jete si meposhte:




Figure 9 - Diagrama e Lidhjes se ODF-ve

Specifikimet teknike te fibres dhe ODF-ve, do te jene si meposhte:

Parametrat e ODF	
Kapaciteti	Min.12 Porta
Lloji i konektorit	LC-Duplex, SM
Instalimi i Konektorit	Me ngjeshje, pa vida (“snap in”)
Materiali i Kases	Metalike
Materiali i pjastres ballore (ku vendosen konektoret)	Metal dhe plastike
Materiali i Kasetave per splice	Plastik (ABS)
Lloji i fibres	G.652.D (SM)
Pigtails	Te perfshira
Etiketimi	Të ketë mundësi për instalimin e etiketave si edhe përdorimin e kodit të ngjyrave

Fibra optike qe do te perdoret do te jete ne perputhje me standardin G.652.D, me 24 fije, e pershtateshme per perdorim te brendshem, me specifikimet e meposhteme.

Parametrat e Fibres Optike	
Lloji i fibres	OS1 9/125 μ m
Numri i fibrave (core)	24
Shuarja ne 1310nm	0.36 dB/km
Lloji i veshjes se jashteme	Poliuretani termoplastik

12.2 Rrjeti Ethernet Baker

Diagrama e lidhes se rrjetit Ethernet do te jete si meposhte:




Figure 10 - Diagrama e Lidhjes se Patch Paneleve

Për terminimin e kabllave Ethernet në Rack do të montohen patch panele modulare me kapacitet minimal 24 porta. Specifikimet e patch paneleve do të jene si meposhte:

Parametrat e kabllit ethernet baker	
Tipi	Patch Panel Modular 1U, 19"
Materiali	Struktura prej çeliku te galvanizuar, pllaka ballore ku vendosen modulet prej materiali palikorbanat.
Kapaciteti	Minimumi 24 porta RJ45 Cat.6A ISO
Lloji i konektoreve	Te skermuar (Shielded)
Frekuenca e konektoreve	500MHz
Mbrojtja	Te gjitha portat te kene kapak, per ti mbrojtur nga pluhurat dhe demtimet
Forma e instalimit te moduleve dhe terminimit te kabllave	Pa vegla, kablli terminohet me ngjeshje ne moduln RJ45 dhe me pas moduli vendoset ne panel ("snap-in")
Tokëzimi	Të jetë i pajisur me elementë të cilët sigurojnë tokëzimin e kabllave.
Etiketimi	Të ketë mundësi për instalimin e etiketave si edhe përdorimin e kodit të ngjyrave
Ngjyra	Gri

Kablli qe do te perdoret per te lidhur patch panelet, do te jete i Kategorise 6A U/FTP.

Parametrat e patch panelit	
Kategoria	Cat.6A
Skermimi	F/UTP

Frekuenca e transmetimit	Min.500Mhz
Karakteristika e veshjes se jashteme	LSZH
Klasifikimi CPR	Dca

12.3 Kanalinat e Verdha

Kanalinat e verdha do te perdoren per kalimin e kabllave te bakrit dhe fibres optike nga kabineti i kabllimit drejt secilit prej kabineteve te serverave. Kanalina do te montohet mbi kabinet, duke perdorur strukture mbajtese qe montohet mbi tavanin e kabineteve. Kanalina duhet te jete e paisur me te gjitha aksesoret per montim, bashkues, tapa fundore, si edhe aksesoret e zbritjes ne secilin kabinet.

Specifikimet e kanalines duhet te jene si meposhte:

Parametrat e kanalines se verdhe	
Gjatesia e kanalines	Shufra standard 2m, te kete mundesine e bashkimit
Dimensionet	160x100mm
Ngjyra	E verdhe
Aksesoret	Tapa fundore, bashkues, aksesore zbritje mbi kabinete, suportet qe kapen mbi kabinete dhe ku fiksohet prizhonieri, prizhonier me filetim M16 dhe lartesi 21cm, mbajtese horizontale e kanalines se verdhe.

Meposhte jepet nje foto ilustruese, mbi formen si duhet te kapet kanalina e verdhe mbi

kabinete.



Figure 11 - Foto ilustruese e kanalines se verdhe

13. KONDICIONIMI

Sistemi i ftohjes me precizion te larte do te perdoret per te mbajtur ne kushte optimale operacionale temperaturen dhe lageshtine relative ne dhomen e serverave. Per kete arsye kondicioneri duhet te jete prodhim per dhoma teknike, i teknologjise me precizion, punim 24/7 dhe 365 dite ne vit.

Per ftohjen e dhomes se serverave do te instalohen dy kondicioner te teknologjise “precision cooling”, me fryrje nga poshte dyshemese.

Secili prej kondicionereve duhet te kete fuqine 12kW, dhe i vetem, duhet te siguroje nje temperature brenda ne dhome rreth 22 °C. Skema e punes se dy kondicionereve duhet te jete njeri ne pune dhe tjetri ne gjendje gadishmerie, me cikel 1 javore (pra nje jave do te funksionoje njeri kondicioner, dhe tjetri do te jete ne gadishmeri, dhe javen tjetere anasjelltas).

Kondicioneret do te fryjne ajrin e ftohte poshte dyshemese, dhe nepermjet grilave te ajrimit te instaluar ne dysheme para kabineteve, do te shperndahet ajri i ftohte. Ndersa ajri i ngrohte qe clirohet nga paisjet ne pjesen e pasme te rackeve, do te thithe nga lart nepermjet kondicionereve te instaluar brenda dhomes.

Sistemi kondicionimit perfshin komponentet e meposhteme:

- Njesite e brendeshme “precision cooling” me fryrje te ajrit nga poshte dhe thithje te ajrit nga lart.
- Kondenserat te cilat instalohen ne pjesen e jashteme per te shkëmbyer nxehtesine.
- Tuba bakri te veshur dhe gas R410A ose gas ekuivalent me ekologjik.

Specifikimet teknike te ketyre komponenteve duhet te jene minimalisht si meposhte.

13.1 Njesite e brendeshme “Precision Cooling”

Parametrat e njesise se brendeshme te ftohesit	
Arkitektura	CRAC me min nje qark ftohes
Funksionet	Ftohje, delageshtim dhe lageshtim
Microprocesor dhe panel operimi	Te perfshire (e preferueshme me touch)
Microprocesori duhet te ofroje	<p>Rindezje automatik ne rast nderprerje te energjise</p> <p>Kontrollin e te pakten dy njesive ne nje sistem</p> <p>Rregjistrim te cdo ngjarje (event log)</p> <p>Rregjistrim dhe shfaqje grafike te parametrave te dhomes</p> <p>Sekuencim te punes me funksion gadishmerie</p> <p>Protokoll ModBUS te instaluar (si edhe protokolle te tjera komunikimi)</p> <p>Operim ne zona</p>
Karte SNMP dhe Eëb	Te perfshire
Kapaciteti nominal i ftohjes	Minimalisht 12kË
Qarkullimi nominal i ajrit	Min 3500m ³ /h
Numri i ventilatoreve	1 ose me shume
Teknologjia e motorrit te ventilatoreve	EC (e rregulluar ne menyre elektronike, nga kontrolleri i njesise)
Klasa e filtrit	EU4
Lloji i ftohesit	R410A ose ekuivalent
Sensore	Temperature dhe lageshtie relative te perfshire
Valvulat e sigurise	Valvule te presionit te larte dhe presionit te ulet

Valvulat e mbylljes	Ne pikat ku lidhet qarku i ftohesit, duhet te kete valvulat e mbylljes (aty ku lidhet tubat qe shkojne ne njesine e jashteme)
Valvula e furnizimit	Njesia e brendeshme duhet te kete min nje valvul per mbushjen me gazin ftohes
Dalje drenazhimi	Njesia e brendeshme duhet te kete nje dalje drenazhimi ne pjesen e poshteme te njesise
Delageshtues	Ngrohës elektrik min me nje faze te perfshire
Lageshtues	Minimalisht min 2kg/h te perfshire
Dedektor uji	Perfshire sensorin dhe valvulen solenoide
Burimi i ushqimit	3-fazor 400V/50Hz
Struktura e njesise	Metalike
Kapakët anesore dhe dera	Prej flete metalike
Garancia	1 Vit

13.2 Kondenseri

Parametrat e kondenserit	
Kapaciteti nominal i ftohjes	Minimalisht 12kĚ
Burimi i ushqimit	1 fazor, 50 Hz
Numri i ventilatoreve	Minimalisht 1
Kontrolli i shpejtesise	Rregullim i presionit per shpejtesi maksimale
Lloji i ftohesit	R410A ose ekuivalent
Struktura e njesise	Metalike, me kafaz alumini anti-korroziv
Mbrojtja IP	Min IP54
Mbrojtja IP e burimit te ushqimit	IP65
Temperatura e punes	Nga -20 deri ne 55°C
Garancia	1 Vit

13.3 Tubat e bakrit

Njësitet e brendshme dhe të jashtme duhet të lidhen me tuba bakri për transportimin e ftohësit. Njesite e jashtme do të instalohet në faqen e jashtme të murit të dhomes së serverave. Njesite e brendshme dhe njesite e jashtme i ndan vetëm faqja e murit (pra distanca midis tyre është shumë e vogël).

Tubat duhet të jenë të izoluar termikisht gjatë gjithë gjatësisë së tyre, për të shmangur humbjet e nxehtësisë dhe kondensimin në sipërfaqe. Tubat nuk duhet të fiksohen direkt në dyshe, apo mure (për të shmangur demtimet ndaj vibrimeve gjatë punës së kompresorit), por duhet të fiksohen me profile C, duke përdorur gomina që mbështjellin kapjen e tubave në profil.

14. SISTEMI I DEDEKTIMIT DHE SHUARJES SE ZJARRIT

Në dhomen e serverave, do të instalohet një sistem për dedektimin dhe shuarjen e zjarrit. Sistemi i shuarjes së zjarrit duhet të jetë me gaz që rekomandohet për dhomat e serverave (NOVEC ose ekuivalent).

Sistemi i dedektimit dhe shuarjes së zjarrit duhet të jetë i projektuar dhe testuar në përputhje me standardet dhe kodet e mëposhtme:

NFPA 2001:	Standarti për Sistemin e Shuarjes së Zjarrit
UL1266:	Standarti për Shuarjen e Zjarrit
ANSI B1.20.1:	Standarti për lidhjet e tubacioneve
NFPA 70:	Kodi për instalimet elektrike
NFPA 72:	Kodi për instalimet e alarmeve të zjarrit

Te gjithë komponentet e sistemit të shuarjes së zjarrit duhet të jenë produkte të të njëjtit prodhues ose të jenë të aprovuara nga prodhuesi si të përshtatshme me pajisjet, komponentët dhe sistemin.

Sistemi i Shuarjes së Zjarrit duhet të plotësojë standardet ndërkombëtare për ruajtjen e shëndetit të njeriut, të pajisjeve hardëare, ruajtjen ekologjike dhe të ambientit, duke plotësuar kërkesat themelore të mëposhtme:

- Instalimet duhet të behen në përputhje me rekomandimet dhe standardet e prodhuesit.
- Në fund të instalimit personeli përgjegjës për Dhomen e Serverave duhet të trajnohet për përdorimin e sistemit.
- Projekti i sistemit me agjentin shuarës të ofruar në zgjidhje duhet të jetë testuar/simuluar nga një softëare i certifikuar nga vete prodhuesi. Pas implementimit dhe testimit të sistemit, këto dokumenta duhet të dorëzohen autoritetit.
- Manualët e përdorimit dhe studimi (projekti) i kryer me softëare nga prodhuesi duhet të dorëzohen së bashku me planvendosjen e komponenteve në dhomen e serverave në përfundim të realizimit të projektit

14.1 Komponentët e Sistemit të Dedektim dhe Shuarjes së Zjarrit

Dhoma e serverave, nga pikëpamja e sistemit të dedektim dhe shuarjes së zjarrit do të jetë e ndarë në 2 zona.

Zona 1: nën dyshemenë teknologjike

Zona 2: mbi dyshemene teknologjike

Në secilën prej këtyre zonave do të instalohen dedektorë tymi dhe sprucatorë.

Komponentët e sistemit të dedektim dhe shuarjes së zjarrit duhet të plotesojnë minimalisht specifikimet e mëposhteme:

14.1.1 Paneli i Kontrollit

Sistemi duhet të bazohet në një panel kontrolli kryesor të pavarur dhe me burim ushqimi nga bateria në rast të shkeputjeve të energjisë. Sistemi duhet të jetë i pajisur me pajisje sinjalizuese alarmi të dëgjueshme dhe të shikueshme të cilët duhet të montohen jashtë dhomes që monitorohet. Butoni i aktivizimi dhe çaktivizimit të alarmit duhet të montohet brenda dhomës së serverave.

Nga pikepamja llogjike ky panel duhet të jetë i ndarë në zonën e hyrjeve (mbledhja e sinjaleve hyrese nga dedektore ose butona që aktivizojnë një alarm), dhe në zonën e daljeve (gjenerimi i sinjaleve nepermjet sirenavë të alarmit dhe aktivizimi i sistemit të shuarjes, i cili mund të shtohet në të ardhmen).

Paneli i kontrollit duhet të jetë i pozicionuar ngjitur me hyrjen kryesore o brenda dhomës së serverave.

Paneli duhet të ketë bateri backup për të siguruar vazhdimësinë e funksionit të tij edhe në rast se mungon energjia kryesore e tij.

Sistemi duhet të jetë i programuar për këto skenarë:

Stand by - Sistemi është në gatishmeri.

Në këtë gjendje sistemi nuk kryen asnjë veprim por vetëm lexon të dhënat nga detektorët e zjarrit në zonat e përcaktuara më lart.

Prealarm (Pre-activated) - Sistemi ka sinjal alarmi (Fire Alarm) nga një prej zonave të mbulimit të zjarrit (kur aktivizohet një sensor në zonën e mbrojtur nga zjarri- temperature ose tym) dhe duhet të iniciojë një alarm në panelin e kontrollit, duhet të aktivizojë sirenat dhe dritat pulsuese në zonën e mbuluar nga ky sensor. Këto sinjale i dergohen dhe personelit për kontrollin dhe monitorimin e mbrojtjes nga zjarri.

Pas ndërhyrjes së operatorëve të sigurisë, në rastin e alarmeve “false”, sistemi mund të kthehet në gjendjen e tij normale nëpërmjet butonave të komandimit në panelin e kontrollit.

Alarm (Activated) - Sistemi ka sinjal alarmi nga të dy zonat e dhomes (sensore temperature dhe detektor tymi). Detektimi i zjarrit nga një sensori i dytë aktivizon “alarmin nga zjarri” dhe në këtë fazë, operatorët e turnit (security/reception) duhet të marrin masa për procesin e shuarjes së zjarrit, në rast se zjarri mund të shuhet nëpërmjet shuarësve portabël me pluhur, ose të verifikojnë nëse kemi të bëjmë me një alarm “fals”, dhe të bëjnë lajmerimet e nevojshme). Në këtë gjendje sistemi jep alarmin për evakuimin e ambjentëve duke ndezur sinjalet dalje dhe duke aktivizuar alarmin e përgjithshëm.

14.1.2 Dedektor Tymi & Temperature

Te këna shpërndarje të tilla që të mbulojnë të gjithë hapësirën e dhomes së serverave. Të jenë në përputhje të plote me sistemin e panelit të kontrollit. Kërkohej të instalohen minimalisht 4 detektore tymi edhe 4 detektor temperature. (nga dy në secilën zonë)

14.1.3 Sirena

Në hyrje të dhomes së serverave, mbi dera duhet të instalohen 1 sirene sinjalizuese me ze dhe drite për sinjalizimin e kalimit të sistemit në fazën “Pre-Activated”, dhe një tabelë me sinjalizimi me drite, ze dhe tekst që sinjalizon fazën “Activated”. Sirena duhet të jetë në përputhje të plote me sistemin e panelit të kontrollit.

14.1.4 Buton i Aktivizimit

Në hyrjen e dhomes së serverave, jashtë dhomes, duhet të montohet butoni i Aktivizimit Manual i cili do të aktivizojë sistemin e shuarjes në rast mosfunksionimi të aktivizimit automatik, si edhe një buton ndalimi që do të përdoret për ndalimin e aktivizimit të shuarjes në rastet kur sistemi është në gjendje “Pre-Activated”. Butonat duhet të jenë në përputhje të plote me sistemin e panelit të kontrollit.

14.1.5 Cilindri dhe Aktivizuesi

Agjenti i shuarjes (Gazi NOVEC ose ekuivalent), depozitohet në një cilindër çeliku i cili minimalisht duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme (ose ekuivalente):

- Cilindri duhet të ketë përberje çeliku dhe duhet të jetë konform direktives TPED (2010/35/EU), Pi (π) 0589 Marking dhe DIN EN ISO 11363-1. Çdo cilindër që mund të instalohet duhet të testohet presioni në një presion provë më të lartë se presioni i punës.
- Cilindri duhet të jetë i prodhuar konform ISO 9809-1 (Gas cylinders — Design, construction and testing of refillable seamless steel gas cylinders and tubes).
- Cilindri duhet të montohet dhe të lidhet në mënyrë të sigurtë.
- Kërkohej që mbi cilindër të shënohen informacione si psh:
 - Kapaciteti Volume (lt) dhe dendësia e mbushjes
 - Peshë neto (kg) e cilindrit.
 - Sasia e shuarjes që përmban (Kg)
 - Peshë bruto (kg)
 - Presioni maksimal i lejuar.

Valvula e Shkarkimit: Valvula e cilindrit duhet te mundesoje rrjedhje te shpejte, qe ne rast aktivizimi te alarmit te beje te mundur shkarkimin e cilindrit ne me pak se 15 sekonda. Valvula e cilindrit duhet te mundesoje aktivizimin me ane te lidhjes elektrike, me aktivizues pneumatik, ose manual duke ushtruar presion mbi pistonin e cilindrit.

14.1.6 Agjenti Shuarës

- Agjenti Shuarës duhet te jete gaz i paster (Novoc ose ekuivalent, por ne asnje menyre nuk

duhen perdorur kopje te tyre dhe gaze jo te paster) - avullon shpejt dhe pa lene mbetje, nuk demton paisjet elektronike.

- Nuk duhet te shkaktoje dëmtime anësore ne ambient ne rast clirimi (te siguroje mbrojtjen e pajisjeve elektronike)

- Potenciali i zbrazjes së ozonit të jetë 0.
- Potenciali i ngrohjes globale të jetë jo më shume se 1
- Kohëzgjatja e jetëgjatësisë në atmosfere jo me shume se 5 ditë
- Koncetrimi i përdorur të jetë më i vogël se 6%
- Marzhi i sigurisë të jetë jo më e vogël se 60%
- Marzhi i ruajtjes së hapësirave të zëna (NOAEL) të jetë jo më pak se 10%
- Garanci të prodhuesit ndaj ndalimit dhe kufizimit të agjentit për shkak të ndryshimit të një prej parametrave të mësipërm, për të paktën 15 vjet.

14.1.7 Sprucatorët e gazit në dalje

Sprucatorët e daljes së gazit duhet të jenë prej alumini per te parandaluar korredimin. Duhet të jenë nga i njejtë prodhues me atë të fikjes së zjarrit me gas.

15. SISTEMI I MONITORIMIT, KONTROLLIT DHE MENAXHIMIT

Per të siguruar parametrat optimale operacional, dhoma duhet te jete e pajisur me nje sistem monitorimi, menaxhimi, kontrolli dhe ndërveprimi të unifikuar. Ky sistem do te sherbeje per dedektimin e anomalive te operimit ne dhomen e serverave, njoftimit me ane te SMS dhe email, si edhe per monitorimin e parametrave te operimit te te gjitha paisjeve.

Ky sistem shfrytezohet dhe sherben per monitorimin dhe kontrollin e sistemeve te instaluara ne dhomen e serverave te integruara në një sistem (nderfaqe) të vetem. Nepermjet tij kontrolli i sistemeve behet jo vetem me i lehte per t'u menaxhuar, por ofron mundesine per te komanduar keto sisteme ne distance. Per garantimin e mirefunksionimit te secilit sistem te integruar ne te, duhet te mundesohet mbledhja e informacioneve dhe sinjalizimeve nga sistemet, dhe menaxhimi i ketyre sistemeve ne varesi te sinjaleve hyrese.

Ky sistem duhet te beje monitorimin e parametrave te meposhtem, nisur nga sensoret e instaluar ne dhome:

1. Temperatures
2. Lageshtires
3. Prezences se ujit

Kondicioneret e instaluar ne dhomen e serverave, duhet të kenë karta komunikimi modbus ose TCP/IP nga ku duhet të merret informacione si nivelin e temperaturës, nivelin e lagështirës relative, mbi nivelin e presionit ne qarkun ftohes, gjendjen e filtrave, mungesen ose tepericen e ujit ne lageshtues, oret e punes se njesise, oret e punes se kompresoreve, alarmet e ndryshme mbi punën e pajisjeve ftohëse, etj. Informacioni duhet të ruhen për një periudhë kohe 6 mujore.

Për secilin nga funksionet që bien në alarm, sistemi duhet të raportojë me ane te SMS ose e-mail sipas prioritetit të alarmit.

Nga sistemi i detektimit të zjarrit duhet te merret informacioni mbis statusin e sistemit (ne regjim normal apo fault), ne Para-Alarm dhe ne Alarm

Sistemi UPS duhet të jete e pajisur karte komunikimi modbus ose TCP/IP nga ku duhet të merret informacioni mbi, nivelin e ngarkesës, kohëzgjatja e furnizimit nga bateria në varësi të ngarkesës, statuset e punës së UPS-së, parametrat e energjise ne hyrje-dalje te pajisjes, kohen kur duhet te meren masa nese pjeset e brendshme te pajisjes jane amortizuar dhe duhen nderuar, alarmet e ndryshme në lidhje me punën e UPS-së, historikun e eventeve, informacioni duhet të ruhet për një periudhë kohe 3 mujore, etj. për secilin nga funksionet që bien në alarm, sistemi duhet të raportojë me ane te SMS, e-mail ose voice call, sipas prioritetit të alarmit.

Pajisjet PDU duhet te kene komunikim TCP/IP ose protokolle komunikimi te pershtatshme per integrimin ne sistemin e monitorimit, menaxhimit dhe kontrollit, ne menyre qe te merren informacione mbi te gjithë parametrat e multimetrit (tensione, rryma, fuqi etj.)

Sistemi duhet te japi historikun e alarmeve te gjeneruara per nje periudhe te percaktuar. Ne te njejten menyre, të gjithë pajisjet e sqaruara me siper kerkohet të integrohen, qe sistemi te mund te krijojë raporte të ndryshme për mënyrën e funksionimit të pajisjeve.

Sistemi, përvec raportimit on-line të gjithë pajisjeve të integruara, duhet të konfigurohet i tille qe te ruajë në database-in e tij gjithë informacioniet e punës së tyre, për një periudhë minimale 6 mujore.

Sistemi i monitorimit dhe kontrollit duhet të konfigurohet i tille qe te japë një paraqitje grafike on-line të te gjitha pajisjeve që do të integrohen dhe monitorohen, si kondicioneri, sensorët e temperaturës, lagështisë, paneli elektrike, etj. Këto pajisje duhet të raportojnë me anë të ngjyrave gjëndjen e tyre.

OE ne baze te paisjeve qe do te ofrojne per realizimin e dhomes se serverave, duhet te ofrojne zgjidhjen e tyre per realizimin e ketije sistemi.

Sistemi duhet te kete komponentet e meposhteme:

15.1 Serveri i Automatizimit

Serveri i atumatizimit (Automation Server) duhet te jete nje njesi e programueshme ku vecse merr te dhena nga paisjet e instaluar per monitorimin e tyre, ben edhe menaxhimin e paisjeve dhe automatizimin e skenareve te ndryshme. Kjo njesi duhet te suportoje protokolle komunikimi si BACnet, KNX, ModBUS. OE jane te lire te ofrojne server automatizimi qofte dhe me nje nga protokollat standarde te industrise, por qe duhet te

integrojne ne kete sistem te gjitha paisjet e projektit si edhe te marrin te dhenat apo kontrollet qe kerkohen me lart.

Serveri i automatizimit duhet te kete minimalisht nje porte Ethernet per tu lidhur ne rrjet, si edhe duhet te kete te integruar funksionin e fireëall per te izoluar sherbime apo protokolle te caktuara, si edhe per te limituar aksesin ne paisje.

Server-i do të duhet nëpërmjet kontakteve I/O (Hyrje/Dalje) te beje minimalisht veprimet automatike si më poshtë:

- Sistemi duhet që të jetë në gjendje që në rastin e detektimit të rrjedhjes së ujit të bllokojë furnizimin me ujë të dhomës.
- Duhet që në rast të detektimit të zjarrit të bëhet e mundur fikja e sistemit të kondicionimit.
- Në rast se sistemi i zjarrit arrin në fazën e lëshimit të agjentit shuarës të bëhet e mundur hapja në mënyre automatike e derës së dhomës.

Për secilën prej sistemeve, ofertuesi duhet të paraqesë projektet, skemat e detajuara per sistemin e monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit dhe të instalimeve në përmasa reale për të shmangur çdo lloj problemi që mund të dalë për shkak të hapësirës ose mosfunksionimit të sistemit.

16. SISTEMI I KONTROLLIT TE AKSESIT

Sistemi i kontrollit te aksesit do te instalohet per te kontrolluar aksesin ne dhomen e serverave. Pra ne hyrje dhe dalje te dhomes se serverave do te insalohen lexues RFID, dhe cdo person qe ka akses ne Dhomen e Serverave duhet te hap deren nepermjet kartes se tije.

Sistemi i kontrollit te aksesit duhet të jete e bazuar në TCP/IP në mënyre që ti ofrohet akses të gjithë personave të cilët do të jene të autorizuar për të pare apo për të konfiguruar sistemin.

Sistemi i aksesit te kontrollit duhet te perbehet minimalisht nga elementet e meposhteme:

Lexuesa: 2 lexuese RFID qe duhet te instalohen ne hyrjen e ambientit te dhomes se serverave, nje ne anen e jashtme, dhe nje ne anen e brendshme, per te lejuar hyrje- daljen e stafit pergjegjes nga dhoma e serverave.

Kontrolleri i sistemit te aksesit - 1 kontrollor (central) i cili duhet te instalohet ne dhomen e serverave. Centrali do te jete i lidhur me 2 lexuesat e instaluar dhe do te lejoje, bazuar ne konfigurimet e regjistruara ne te, hyrjen vetem te personave te autorizuar per te patur akses ne kete dhome. Karakteristikat minimale te kontrollorit jepen ne paragrafet e meposhtem.

Brava elektromagnetike: – sistemi i aksesit duhet te perfshije 1 magnet qe do te instalohet ne deren antizjarr per te mos lejuar hapjen e saj nga staf i pa pajisur me karta aksesi. Karakteristikat minimale te magnetit jepen ne paragrafin e meposhtem.

Karta aksesi – minimalisht 10 karta aksesi per te lejuar hyrjen e stafit te autorizuar ne ambientin e dhomes se serverave.

Karakteristikat e kontrollerit (hardëare)

Akses kontrolli duhet të ketë këto karakteristika të përgjithshme:

Memorie të brëndshme për minimalisht 200,000 ngjarje

Ushqimi: 10-30V DC dhe PoE IEEE 802.3af/at

Komunikimi TCP/IP, RS-485

Siguria e rrjetit: Filtrim i adresave IP, enkriptim HTTPS, mbrojtje me fjalëkalim

Temperaturat e operimit: nga 0°C to +45°C

Të ofroje mundësinë e autentifikimit vetëm me karte, vetëm me PIN ose me karte edhe me PIN.

Centrali duhet të ofroje ndërrim i PIN, ndërrim i kartës, shtimi apo heqja e përdoruesve si edhe ndryshimi i skedulimeve të akseseve.

Lexuesit

Lexuesit duhet të suportojnë karte dhe PIN

Teknologjitë e leximit: Generic 13,56 MHz (MIFARE Classic, MIFARE Plus, vMIFARE DESFire EV1

Temperaturat e punës: nga -10 ° C në + 50 ° C

I pajisur me tamper për të detektuar në qofte se hiqet nga muri.

Sinjalizimin për: Akses i konfirmuar (Access Granted), Akses i refuzuar (Access Denied), armed, disarmed

Magneti

Deri në 300 kg e forcës mbajtëse

E monitorueshme

12/24 VDC

Status me led për gjendjen e derës

17. SISTEMI CCTV

Per te monitoruar aktivitetin dhe aksesin ne dhomen e serverave, duhet te insalohet nje sistemi video survejimi. Sistemi duhet te jete i teknologjise IP, duhet te perfshije 3 kamera dhe nje video rregjistrator per rregjistrimin e videove.

Komponentet e ketije sistemi do te jene:

Video Rregjistrator (NVR)

Kamera

Meposhte jepen specifikimet minimale qe duhet te plotesojne paisjet:

NVR

Karakteristikat	Vlerat specifike minimale
Numri i kanaleve hyrëse	8 kanale ose me shume
Kapaciteti i trafikut ne regjistrim-Recording Bandëidh	Min. 120 Mbps
Rezolucioni maksimal në regjistrim	Min. 6 MP
Rishikimi i njëkohshëm - Synchron Playback	deri në 8 kanale
Formati i Videos	H.264 ose me mire
Kapaciteti i numrit të Hard-disqeve	2
Kapaciteti fizik i disqeve	Deri në 6 TB
HDD te përfshira	2x4TB HDD
Porta e rrjetit	Min 1x RJ-45 10/100/1000 Mbps
Portat USB	1xUSB 2.0 ose me shume; 1xUSB 3.0 ose me shume;
Temperaturat e operimit	0 deri në +45° C

Kamera

Karakteristikat	Vlerat specifike minimale
Tipi i kameres (“Type of camera”)	Bullet ose Dome
Procesori i figures (“Image Sensor”)	Skanim progresiv CMOS SENSOR 1/2.8
Rezolucioni i figures (“Resolution”)	Minimumi 2880x1620
Frekuenca e kuadrove (“Frame Rate”)	Minimumi 20 fps
Reduktimi i zhurmës (“Noise Reduction”)	3D DNR
Tipi i lenteve (“Lens Type”)	Fikse
Gjatesia fokale (“Local length”)	2.8mm,
Ndjeshmeria drites në 50 IRE, (“Min. Illumination @50IRE,)	Color 0.01 lux; B/Ë 0 lux ëith IR
Ndriçimi Infra të Kuqe (“IR illuminators”)	30 m;
Rezistenca ndaj pluhurit dhe shiut	IP68
Dite/Nate (“Day/Night”)	Filter per prerje IR
Diapazoni dinamik i ndjeshmerise, (Ëide Dynamic range)	Po (“Yes”), min 120 dB
Formati i kompresimit të Videos	H.264 ose me mire
Dedektim i levizjes (“Motion Detection”)	Po
Pajtueshmeria e sistemit (“System support”)	ONVIF
Multi-streaming	Min. Dual stream

Temperatura e operimit (“Operating Temperature”)	-10°C - +50°C
Ushqimi (“Poëer”)	PoE
Aksesore per montimin	Po, sipas tipit të kameres dhe menyres se montimit

18. FIREËALL

Karakteristikat e përgjithshme:

- Zgjidhja duhet të ofrohet si platformë e gjeneratës së re me arkitekturë multicore dhe funksione si optimizim të fireëall, funksione të inspektimit dhe kërcënimeve të ndryshme.
- Zgjidhja duhet të ofrohet si pajisje fizike dhe të jete e instalueshme në rack, të ketë të pakten 10 x 10/100/1000 porta Gigabit Ethernet.
- Zgjidhja të suportoje porta 1/10Gb SFP.
- Zgjidhja të ketë të pakten një portë menaxhimi 1 x 10/100/1000.
- Zgjidhja të ofrojë fireëall throughput të pakten 9 Gbps.
- Zgjidhja të ofrojë throughput me funksion IPS dhe Application Control të pakten 3.4 Gbps.
- Zgjidhja të ofrojë throughput të parandalimit të kërcënimeve të pakten 2.5Gbps
- Zgjidhja të suportoje të pakten 65k sesione të reja/sekonde
- Zgjidhja të suportoje të pakten 2M sesione të njëkoheshme.
- Zgjidhja të ofrojë VPN Throughput të eknriptuar të pakten 2.5 Gbps
- Zgjidhja të ketë dy burime ushqimi AC dhe të përfshijë të pakten 200 GB storage
- Zgjidhja duhet të ofrojë protokolle rutimi si: ospf, bgprip, pbr, multicast routing etj.
- Zgjidhja të suportoje L2 transparent dhe routed mode, Active- Active Active-Pasiv.
- Zgjidhja të suportoje të pakten 10 sisteme virtuale.
- Sistemi është në gjendje të sigurojë analizë dhe mbrojtje ndaj kërcënimeve duke patur një vizibilitet të endpoint me aplikacionet, sistemin operativ, dobësitë, informacionin e pajisjes, përdoruesit e lidhur me ngjarjet e sigurisë
- Sistemi duhet të ofrojë monitorim të: ndryshimeve të komunikimeve, ndryshimet e fileve të sistemit, regjistrat e sistemit, bypass për akses të përdoruesve, monitorim direkt të cpu, memorjes, monitorim të kernel code etj.
- Zgjidhja duhet të suportoje deri në 4096 Vlan interface.
- Zgjidhja të përfshijë protokolle për mbrojtje dhe rrugëzim të trafikut në ndërfaqen ean, vpn, disponueshmëri të lartë, failover.

Menaxhimi:

- Zgjidhja të ofrojë platformë menaxhimi të qëndrueshme.
- Zgjidhja të ketë të përfshirë me pajisjen një platformë bazuar në broësor për të shqarë politikën e sigurisë read-only, menaxhim të logove, menaxhim të të drejtave të përdoruesve etj,
- Zgjidhja të ketë të integruar një platformë menaxhimi me nivel të lartë sigurie, të suportoje SSL, konfigurim të portave etj.
- Zgjidhja të ofrojë monitorim të çdo eventi operacional, e shoqëruar me shfaqje të sensorëve, led-e për përcaktimin e statusit të ndërfaqes.

Licensimi dhe garancia:

- Licensimi të jetë i përfshirë me pajisjen për shërbimet si: vizibilitet dhe kontroll të kapacitetit, mbrojtje të avancuar për malëare në rrjet, filtrim të url; sistemi i parandalimit të ndërhyrjeve, parandalim të bad bot, parandalim të virus, Zero-Day, CDR.
- Garancia të ofrohet për një periudhë 1 vjeçare për hardëare dhe softëare.
- Garancia të ofrohet për një periudhë 1 vjeçare për të gjitha licensat të përfshira në zgjidhje
- Garancia të ofrohet të përfshijë të pakten 1 vit disponueshmëri për përmirësim të softëare.
- softëare.

19. SERVER (nyja e perpunimit të informacionit)

Serveri duhet të jetë i instalueshëm në kabinet standart dhe të ketë lartësi jo më shumë se 1U.

Serveri duhet të përfshijë kit instalimi për kabinetin dhe kit për shoqërimin e kabllëve.

Serveri duhet të shoqërohet nga një set kabllësh për furnizimin e tyre me energji elektrike.

Serverët duhet të kenë të paktën:

- a) dy procesorë të instaluar me jo më pak se 16 core secili,
- b) frekuencë jo më të vogël se 2.2 Ghz,
- c) memorje me një frekuencë të paktën 4800 MT/s,
- d) cache jo më e vogël se 30 MB,
- e) të ketë mundësi të punojë në aplikacione me arkitekturë 64-bit në nivel harduer.

Serveri duhet të ketë të paktën 256 GB DDR4 me një 4800 MT/s.

Serveri të suportoje deri në 32 module memorie me frekuencë deri në 4800 MT/s dhe mbështet deri në 8 TB memorie.

Serveri të ketë mundësi të instalohen në shasinë deri në 8 hard disqeve të llojeve të disqeve SAS, NVMe, SSD.

Serveri duhet të përfshijë kapacitet për sistemin të paktën 480 disqe SSD pas konfigurimit në RAID1.

Serveri duhet të ketë të paktën 3 (tre) PCIe slotë për zgjerueshmeri.

Serveri duhet të përfshijë të paktën 1 (një) kartë rrjeti me 2 (dy) porta SFP+ 10 GB me kabllo të përfshira për tu lidhur në TOR dhe 2 (dy) porta 1000 BASE-T.

Serveri duhet të përfshijë të paktën një kartë fibër me dy porta minimalisht 16 Gb/sek me modulet SFP të përfshira.

Serveri duhet të përfshijë një panel ballor me një çelës për të mos lejuar hyrjen e drejtpërdrejtë në hard disk, porta USB, butonat e disponueshëm në pjesën ballor të serverit nga të cilat mund të kryhet start up i pajisjes.

Serveri duhet të ketë një kontrollor fizik me një ndërfaqe minimumi SAS me shpejtësi prej 12 Gbps dhe një memorie cache prej 4 GB.

Serveri duhet të ketë 2 (dy) hot plug poëer supply redundante me kapacitet prej min. 750 Ë secila.

Serveri duhet të ketë fane redundante.

Serveri duhet të suportoje sisteme operative të tilla si:

- a) Microsoft Windows Server;
- b) Red Hat Enterprise Linux
- c) SUSE Linux Enterprise Server;

d) VMëare ESXi;

e) Ubuntu;

Serveri duhet të ketë harduer, softuer për kontroll dhe monitorim në distancë, duke ofruar funksionalitetet e mëposhtme:

a) Konsola e menaxhimit në distancë për të hyrë në pajisje përmes ëeb broëser, CLI, IPMI dhe Redfish.

b) Te informoje ne menyre automatike me email administratorin për çdo defekt që mund të ndodhë si: keqfunksionim i disqeve, moduleve të memories, poëer supply, faneve dhe procesorëve. Gjithashtu keto defekte te shfaqen edhe nepermjet consoles se administrimit.

c) Te shfaqe informacion rreth komponentëve të instaluar në pajisje, te shfaqe informacion te mikrokodeve të versioneve të komponentëve të serverit, informacion per mac-adresat, ËËN të kontrollerave të rrjetit, kartave fiber dhe ato virtuale.

d) Te kete mundesi rindezje, fikje dhe ndezje ne largesi te pajisjes (perfshire dhe boot-im nga drive-e virtuale).

f) Ndërhyrja në distancë nepermjet consoles se menaxhimit (konsolës virtuale): ekrani, tastiera, treguesi grafik i koordinatave gjatë fazës së ngarkimit të pajisjes dhe gjatë funksionimit të sistemit operativ. Konsola virtuale duhet te suportoje funksionalitet gjate perdorimit te ëeb broëser dhe HTML5 standarte, pa ndihmen e softëare te treta si Java dhe ActiveX plug-ins.

g) Mundësi të mbled informacion rreth nivelit te perdorimit te CPU dhe memorjes RAM te serverit pa nevojen e instalimit te agjenteve ne systemin e operimit.

h) Mundesi shfaqje nepermjet nderfaqes ëeb ose cli per te eksportuar informacion per diagnostifikimin e statusit te pajisjes, perfshire loge nga moduli i menaxhimit te pajisjes dhe sistemit operativ ose loge te hypervisor ne nje raport te vetem.

i) Te suportoje shkrimin e konfigurimeve te moduleve te kontrollit ne nje drive te dedikuar i instaluar ne brendesi te pajisjes, per te rivendosur statusin e serverit ne rastin e nderrimit te bordit,

j) Mundesi per te kryer perditsim te mikrokodeve te komponenteve te pajisjeve ndepermjet nje moduli nderfaqe menaxhimi dhe perditsim te sistemeve operative te suportuar.

k) Paisjet duhet te jene të reja, të papërdorura, të përfshijnë të gjitha përmirësimet e fundit në dizajn dhe materiale dhe nuk janë deklaruar nga prodhuesi si end of sale ose end of availability.

Duhet te ofrohet mbrojtje e te dhenave ne perdorim te drive-e fizik gjate funksionimit te serverit, gjate zvendesimi te hard drive-e,

Server te ofrohet me license Ëindoës Server Standard 2022 e licensuar per te gjithë coret.

Duhet te ofrohet garanci nga prodhuesi per nje periudhe minimumi 3 (tre) vjecare per hardëare dhe softëare.

20. DATA STORAGE

Pershkrimi	Specifikimi
Arkitektura / Storage Controller	<p>Sistemi storage duhet te kete dy kontrollera ne operim qe punojne si aktiv-aktiv.</p> <p>Sistemi duhet te ofroje failover automatic ne rast deshtimi te nje kontrolleri.</p> <p>Sistemi storage nuk duhet te kete komponent SPOF (Single point of failure).</p> <p>Disponueshmeri e te dhenave 100% e garantuar duhet te jete e deklaruar qarte ne site e vendorit per modelin e ofruar. Nese vendor nuk suporton disponueshmeri 100% te deklaruar ne �ebsite, atehere operatori duhet te ofertoje controller shtese dhe 10% me kapacitet shtese si cold spare per te perballuar raste deshtimi.</p>
Cache/Memorie	<p>Sistemi duhet te ofroje te pakten 512GB memorie</p> <p>Pas nje nd�rprerjeje t� plot� t� energjis�, shkrimet q� jan� pranuar nga host-i duhet t� rikuperohen pa pasur nevoj� p�r battery backed mirrored �rite caches.</p>
Kapaciteti	<p>Sistemi storage duhet te ofrohet si nje zgjidhje all flash / all NVMe.</p> <p>Storage duhet te perfshije te pakten kapacitet 30TB RA�.</p> <p>Storage mund te zgjerohet deri ne 2PB.</p> <p>Sistemi duhet te jete I shkallezueshem deri ne te pakten 72 disqe flash.</p> <p>Storage duhet te ofroje mundesi e te pakten 250 hosteve per te komunikuar me porta FC.</p> <p>Storage duhet te suportojte deri ne 30,000 LUNs.</p> <p>Storage duhet te ofroje te pakten 1000 snapshotte per LUN.</p> <p>Storage duhet te suportojte te pakten 150k IOPS (8k block, 60/40 r/� ration, <1ms response time) me deduplikim dhe kompresim active. Performanca duhet te provohet me raport zyrtar nga konfiguratori i prodhuesit (sizing/configurator tool).</p> <p>Operatoret duhet te ofrojne vetem disqe te enkriptuar me licencat perkatese te enkriptimit. Operatoret nuk duhet te ofrojne enkriptim te bazuar ne controller ose ne softuer.</p>
Komunikimi	<p>Sistemi storage I ofruar duhet et kete te pakten nje porte menaxhimi Ethernet per secalin controller, per menaxhim te jashtem ne group.</p>

	<p>Storage duhet te perfshije te pakten 4 porta 16/32 Gbps FC per kontrolller. Perfshire edhe 2 modulet SFP 32Gbps per kontrolller.</p> <p>Storage duhet te perfshine te pakten 2 porta x 10 Gbps iSCSI Ethernet per kontrolller</p>
	Storage duhet te suportoje protokollet si: FC, iSCSI, NVMeoF-FC, NVMeoF-TCP.
RAID	Storage duhet te suportoje RAID 6.
Shkallëzimi/Përmirësim i/ Mbrojtja e Investimeve	Storage te kete mundesi pershkallezimi për të siguruar nevojat në të ardhmen.
Sistemi i Operimit	Storage te kete sistem operativ të optimizuar që të sigurojë të gjitha protokollet për menaxhimin e Storage-it.
Menaxhimi dhe softëare per menaxhim dhe konfigurim	Sistemi i menaxhimit te jete lehtesisht në përdorimin e GUI-t dhe administrimin e ndërfaqes e aktivizuar nga ËEB-i, për konfigurime, menaxhimin e Storage dhe funksionalitete raportesh. Sistemi Storage duhet te ofrohet i shoqeruar me nje softëare per konfigurimin dhe menaxhimin. Softëare i menaxhimit duhet te ofroje mundesi per monitorim te performances historike dhe ne kohe reale.
Suporti i Sistemit të Operimit	Te ofroje suport te file-ve të sistemit për serverat në ekzekutim, me platformat industri- lider të Sistemeve të Operimit jane të përfshira: Microsoft Ëindoës Server, Microsoft Hyper-V, VMëare vSphere, Red Hat Enterprise Linux.
Mirëmbajtje	Sistemi i propozuar te suportoje monitorim në distancë te statusit, kontroll, menaxhim dhe konfigurim i të gjitha funksionaliteteve të kërkuara qe janë të aktivizuara nëpërmjet ndërfaqes grafike, ndërfaqes së linjës së komandës dhe API-së
AC Poëer	Sistemi te ofroje redundant paëer supply 200-240 VAC, 50Hz (përfshirë dhe kabllot e ushqimit).
Montimi në Rack	Sistemi te jete i montueshëm në rack, perfshire dhe aksesoret e montimit.
Kabllot FC	Sistemi të ketë të perfshire kabujt fiber dhe kabujt e ushqimit.
Softëare	<p>Sistemi duhet te ofroje nje platfome menaxhimi per provizionim te storage me minuta.</p> <p>Sistemi të ketë mundesi te kryeje përditsime pa ndërprerje gjatë orëve të punës.</p> <p>Sistemi të ketë funksionalitete:</p> <ul style="list-style-type: none"> • deduplication, • data compression, • encryption, • thin provisioning, • snapshot, • clone,

	<ul style="list-style-type: none"> • ërite protection and volume reconfiguration • Quality of service <p>Sistemi duhet të ketë mundësi integrimi nepermjet platformave Openshift, Containers, Vmëare.</p> <p>Storage I ofruar duhet te jete multi-tenant dhe duhet te suportojte te pakten 128 Tenante per cdo storage array. Cdo tenant duhet te trajtohet si nje storage logjik I vecuar me akses kontrolli te ndara,</p> <p>Sitemi duhet të suportojë synchronous dhe asynchronous replication dhe te perfshije licencat per te.</p> <p>Sistemi të suportojte active-active metro cluster midis storage të ndryshem me llogjiken e nje single storage volume. Licensa per kete te jete e perfshire.</p>
Licencat	Të gjitha licencat e sistemit Storage te jene te ofruara nga dita e parë për kapacitetin e ofruar nga storage.
Garancia	Të gjitha HË & SË duhet te ofrohen me 3 vite garanci nga prodhuesi. Prodhuesi te ofroje 100% garanci dhe disponueshmeri te te dhenave.

21. SËITCH "Top of the Rack"

Porta doënlk SFP+/SFP28	Min. 48 porta 1G/10G SFP/SFP+ aktive
Porta Uplink 40/100Gbps	Min. 6 porta QSFP+
Porta Console RJ-45/USB	1
Instalimi në Rack	i montueshem ne rack dhe kit
HYRJE "INPUT"	
Tensioni Nominal	120-240 V AC
Frekuenca	50/60 Hz
Modul ushqimi N+1	Po
FAN N+1	Po
PERFORMANCA DHE FLEKSIBILITETI	
Sëitching Capacity	≥ 1,800Gbps
Forëarding Rate	≥ 1,000 Mpps
Flash Memory	≥ 8 GB
DRAM	≥ 16 GB
Ethernet Jumbo frame	≥ 9,000 bytes
Tabelë të Adresave MAC	≥ 90k
Instanca te Virtual Routing and Forëarding (VRF)	Po
ECMP	Po
STANDARDET	
IEEE 802.3ae - 10GBASE-SR	Po

IEEE 802.3ba - 40 Gbit/s and 100 Gbit/s Ethernet	Po
IEEE802.3z - 1000BASE-SX	Po
IEEE 802.3ad - Agregim linku	Po
IEEE 802.3x - full duplex and floë control per portat	Po
IEEE 802.1d - Spanning Tree Protocol	Po
IEEE 802.1s - multi STP	Po
IEEE 802.1ë - RSTP	Po
SISTEMI OPERATIV	
Të Jetë i Orientuar për Operacionet LAN Data Center	Po
Të Ketë Mundësi për Upgrade, Doënggrade	Po
VECORITË NË LAYER 2 DHE 3	
IGMP Snooping	Po
Spanning Tree	Po
LLDP	Po
BPDU Filtering/Guard	Po
Detektim të Loopback	Po
802.3x Floë Control	Po
VLAN ID	4000
Agregim të Linkeve	802.3ad LACP
Policy-Based Routing (PBR)	Po
Routim	Po
SIGURIA	Po
Access Control List	Po
TCP/UDP Ports	Po
Storm Control	Broadcast, Multicast, Unicast
MENAXHIMI	
Ëeb-based GUI dhe /ose CLI	Po
USB Console / RJ-45 Console	Po
SSH	Po
Monitorim të CPU	Po
SNTP / NTP	Po
Upgrade/Doënggrade të Firmëare	Po
Indikator LED	Opsionale
SNMP v1/v2c/v3	Po
SYSLOG	Po
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:	3 vjet

22. Zgjidhje backup Disk to Disk dhe softëare per backup dhe replikim

22.1. Zgjidhja per backup Disk to Disk.

- Pajisja e ofruar per Disk to disk backup duhet te jete nje appliance e ndertuar per ate qellim dhe duhet te jete e certifikuar per te punuar me te pakten 3 prodhues te aplikacioneve backup.
- Pajisja duhet te ofrohet me te pakten 80TB kapacitet raë dhe te jete i shkallezueshem deri ne 230TB.
- Zgjidhja duhet te kete disqe te dedikuar per systemin operativ te pajisjes dhe nuk do te jene pjese e data backup.
- Pajisja e ofruar duhet te jete e shkallezueshme deri ne te pakten 180TB kapacitet te perdorshem (usable capacity in native mode) pa deduplikim dhe kompresim dhe deri ne 350TB kapacitet native shtese duke perdorur storage ne cloud si AËS, Azure ose object storage.
- Pajisja e ofruar duhet te jete e mbrojtur me hardëare raid 6 nga fabrika duke mos qene nevoja per konfigurim Raid ne site.
- Pajisja e ofruar duhet te jete e konfiguruar me te pakten nje hot spare disk.
- Pajisja e ofruar duhet te supportoje emulim per VTL dhe NAS targets si per shembull NFS & CIFS.3
- Pajisja e ofruar duhet te kete mundesi te konfiguroje te pakten kombinim te 32 tape Librarive & NAS targets.
- Pajisja e ofruar duhet te kete licence deduplikimi te integruar, licence replikimi loë bandëidh ne menyre qe vetem blloqet e paduplikuara te transferohen ne remote/DR site.
- Pajisja e ofruar duhet te jete inteligjente per te kuptuar deduplikimin ne burim dhe ne target (source-based and target based deduplication) dhe duhet te integrohet me te gjithë backup ISVs e njohur. (te pakten 3 ISVs duhet te suportohen).
- Pajisja e ofruar duhet te kete aftesi per te emuloje formate tape drive/ tape LTO-Gen5, LTO-Gen6, dhe LTO-Gen7 etj.
- Pajisja duhet te ofrohet me min. 2 x 10/25Gbps SFP IP ports dhe 2 x 16/32Gbps ports. Licencat dhe SFP per te gjitha portat duhet te perfshihen.
- Pajisja e ofruar duhet te suportoje lidhjen e portave FC direct ne server ose nepermjet SAN sëitcheve nderkohe qe suporton source dhe target based de-duplication.
- Pajisja e ofruar duhet te suportoje funksionalitet per enkriptim.
- Pajisja e ofruar duhet te suportoje dual authorization per te penguar operacione shkaterrim nga hakerat duke I penguar te ekzekutojne operacione kritike si fshirje te backupeve, nderrim te ores se sistemit etj.
- Dual authorization duhet te aprovohet nga dy accounte ose entitete te ndryshme nevend te nje accounti/entiteti te vetem pergjegjes, ne menyre qe te parandalohen efektivisht sulme ransomëare.
- Pajisja e ofruar duhet te suportoje nje cilesi per fshirje te sigurt per te ruajtur te dhenat nga rikuperim i paautorizuar I te dhenave te fshira.

- Pajisja e ofruar duhet te suportoje performance shkirmi te pakten 24TB ne ore.

22.2. Softëare per Backup

Kerkesat kryesore qe duhet te plotesoje sistemi per backup dhe replikim jane si me poshte:
Backup dhe restore:

- Te mund te kryeje backup të makinave virtuale, serverëve fizikë dhe ngarkesave të punës në cloud.

-
- Te suportojë replikimin e VM-ve për qëllime të rikuperimit nga fatkeqësitë.

Backup i bazuar në imazh:

- Te krijojë kopje rezervë të bazuara në imazhe për të gjitha makinat virtuale ose serverët fizikë.
- Te mund të kape snapshot të plota të sistemit për rikuperim të shpejtë.

Backup incremental dhe diferenciale:

- Te mund të realizojë backup efikase të tipit inkremental dhe diferenciale për të zvogëluar kërkesat e ruajtjes së backup dhe kohëzgjatjen e kryerjes së backup.

Rikuperimi i menjëhershëm i VM:

- Te mundesojë rikuperimin e shpejtë të makinave virtuale (VM) nga backup, duke i lejuar ato të ekzekutohen drejtpërdrejt nga skedari backup

Rikuperimi granular:

- Te mundesojë aktivizimin e restore granular të skedarëve, dosjeve ose të aplikacioneve specifike nga kopjet backup pa pasur nevojë të bëhet restore të gjithë VM-në.

Zhdukja dhe kompresimi i të dhënave:

- Te zvogëlojë konsumin e kapacitetit ruajtjes përmes teknikave të de-dublikimit dhe kompresimit të të dhënave.

Integrimi me snapshotet e ruajtjes:

- Te integrohet me storage snapshots për të mundësuar kryerjen e backup me të shpejtë dhe efikas

Backup target fleksibel:

- Te ofrojë suport për target të ndryshëm të backup duke përfshirë ruajtjen lokale, ruajtjen në (NAS) dhe ruajtjen në cloud kompjuterike.

Menaxhimi i ciklit jetësor të të dhënave:

- Te ofrojë mundësi për përcaktimin e politikave të ruajtjes së kopjeve rezervë dhe konfigurimin e rule-ve të menaxhimit të ciklit jetësor të të dhënave për të automatizuar vjetërsimin dhe fshirjen e të dhënave.

ËAN acceleration:

- Te mundesojë optimizimin e trafikut gjatë procesit të kryerjes së backup në ËAN duke reduktuar konsumin e bandëidht.

Backup dhe restore në cloud:

- Mbështetje për backup dhe restore të ngarkesave të punës në cloud publike si AËS dhe Azure.

Backup të tipit application-afare:

- Te mund të realizojë backup duke siguruar konsistencën e të dhënave dhe aplikacioneve në kopjet backup të bazave të të dhënave dhe aplikacioneve kritike

Kriptimi dhe siguria:

- Te mundesojë kriptimin e të dhënave të backup “at rest” dhe “in transit” për të mbrojtur informacionin e ndjeshëm.

Monitorimi dhe raportimi:

- Te mundesojë monitorim në kohë reale të job-eve backup dhe të sigurojë raportim gjithëpërfshirës mbi aktivitetet e backup dhe restore.

Kontrolli i qasjes me bazë roli (RBAC):

- Te mundesojë zbatimin e RBAC për të kontrolluar aksesin në funksionet e backup dhe restore.

Testimi dhe verifikimi i automatizuar:

- Te mundesojë verifikimin automatikisht të restore-it të backup-eve përmes funksionit të testimit të automatizuar .

Explorers:

- Te mund te ofroje mjete të specializuara (p.sh., Explorer për Microsoft Exchange, SQL Server, SharePoint file server etj) për rikuperimin granular të aplikacionit.

Tape backup:

- Te ofroje mbështetje për arkivimin e kopjeve backup në kasetë për mbajtje afatgjatë dhe pajtueshmëri me rregulloret e sigurise.

Mbështetje për Hyper-V dhe VMëare:

- Te ofroje pajtueshmëri me të dy platformat kryesore te virtualizimit qe aktualisht disponon AKSHI, Hyper-V dhe VMëare.

Mbrojtja e vazhdueshme e të dhënave (Continuous Data Protection):

- Te ofroje mbështetje për mbrojtjen e vazhdueshme të të dhënave për të reduktuar humbjen e të dhënave në rast fatkeqësish.

Verifikim te automatizuar per restore:

- Te ofroje nje funksion te dedikuar per verifikimin e automatizuar te rikthimit te te dhenave nga backup.

Licensimi:

- Softëare duhet të jetë i licensuar per 20 Makina virtuale për min. 1 vit, duke përfshirë mbështetjen e prodhuesit

23. SAN SËITCH

Përshkrimi	Kërkesa
Portat	32 Fiber channel ports me shpejtësi 16/32 Gbps Min. 8 porta active
Bandëidh	min. deri ne 768 Gbps
Akesorët e nevojshëm (Modulet SFP, FC kabllot) për lidhjen redundante të sëitcheve me SAN Storage	
Sëitch duhet të ofrohet me liçensë për të paktën 8 porta FC x 32Gb. Çdo sëitch duhet të ketë mundësi zgjerimi deri ne 32 porta për përdorim të metejshëm në të ardhme me shtimin e liçensave.	
Burimi i ushqimit	Redundant dhe hot-sëappable
Fans	Hot-sëappable
Garancia	Min. 1 vit

24. Sherbime instalimi dhe konfigurimi

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 përkatësisht në është 604.930.133 (gjashtëqind e kater mije e nenteqind e tridhjetë presje njeqind e tridhjetë e tre) lekë.*

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës në monedhën ndërkombetare Euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 6.163,32(gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre presje tridhjetë e dy) euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 31.12.2024 është 98.15 euro.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021,2022,2023) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.

Nëse kërkohen bilance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2024)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshillave Bashkiake të njëjësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2.4.Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2024 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

-
- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara, ose,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën 6 (gjashtë) punonjës të çertifikuar nga prodhuesit e zgjidhjes që do ofrohet. Punonjësit duhet të jenë të kombinuar si më poshtë:

- a. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në ITIL (ose ekuivalente) për menaxhimin e shërbimeve TI.

Certifikime për pajisjet dhe platformat që do të furnizohen

- b. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet e rrjetit sëitch.
- c. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet e sigurisë (fireëall).
- d. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjet server.
- e. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për pajisjen storage.
- f. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për virtualizim.

Certifikime për pajisjet dhe platformat ekzistuese

- g. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për pajisjet storage ekzistuese IBM.
- h. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për pajisjet ekzistuese të tipit sëitch HPE.

Për secilin prej tyre të dorëzohen çertifikatat përkatëse. Çertifikatat të cilave u ka kaluar afati i vlefshmërisë janë objekt skualifikimi.

Punonjësit e çertifikuar duhet të garantohen që do të dedikohen për objektin e këtij prokurimi pranë Autoritetit Kontraktor dhe Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që i ka të punësuar prej një periudhe të paktën 3 muajore nga data e dorëzimit të ofertës duke paraqitur :

- Kontratat e punësimit
- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësit për 3 muajt e fundit

-
- List pagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit.

Shënim: Për piken 2.3.1 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

1.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesit e pajisjeve të ofruara (Server, Storage, Fireëall, Sëitch) për shitjen dhe suportin për territorin e Republikës së Shqipërisë (të dorëzojë MAF-et përkatës). Autorizimet duhet të jenë të dedikuara për objektin e prokurimit dhe të përmbajnë kontaktet e nevojshme (emer, email, telefon) për të verifikuar autenticitetin e tyre.

1.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve nderkombetare ISO me certifikimet e mëposhtme:

- Certifikate për menaxhimin e cilësisë ISO 9001:2015;
- Certifikate për menaxhimin e sigurisë së informacionit ISO 27001:2023.
- Certifikate për menaxhimin e shërbimeve ISO/IEC 20000-1:2018;
- Certifikate për vazhdimësinë e biznesit ISO 22301:2019;

Në përmbushje këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e vlefshme ISO. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili prej operatorëve duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

